



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 21.08.2024

Nr: 18

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 10, DATË 04.08.2024 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI Z. DHIONISIOS ALFRED BELERI.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 04.06.2024, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Z. Dhionisios Alfred Beleri

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë z. Dhionisios (Alfred) Beleri, propozuar nga koalicioni Bashkë Fitojmë”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 12/5, 7, neni 21, pika 1 shkronja “b”, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 21.8.2024 Nr: 18
Ora: 11:30



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 10, datë 04.08.2024 të depozituar nga z. Dhionisios Alfred Beleri”

VËREN:

Z. Dhionisios Alfred Beleri, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 10 regj., datë 4.8.2024.

Në mbledhjen e datës 21.08.2024, pas relativitetit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 10, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 10, datë 04.08.2024, të paraqitur nga z. Dhionisios Alfred Beleri.
2. Kërkesa ankimore do të shqyrtohet bashkërisht me kërkesën ankimore nr. 09, në seancën e datës 12.09.2024, ora 11:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	Lako	-	Anëtar
Elvis	Çefa	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar